



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



Nr. 42/2020
Datë: 21.04.2020

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në Vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë të dt.14.04.2020 **për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në teritorin e komunës(ve) në karantinë, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik, në këtë situatë pandemie, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nxjerrë këtë:**

NJOFTIM

Për të gjitha Autoritetet Kontraktuese (AK) dhe Operatorët Ekonomik (OE) për të bërë më të lehtë procesin e tenderimit, për shkak situatës se krijuar si rezultat i Corona Virusi-it COVID-19, Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik **OBLIGON** Autoritetet Kontraktuese që të marrin masat si më poshtë :

- I. Meqenëse kërkesa për Sigurimin e Tenderit sipas LPP-së nuk është mandatorë , AK-të mund të mos kërkojnë një siguri të tillë. Megjithatë nëse AK-të e konsiderojnë si të domosdoshme vendosjen e një kërkesë të tillë në dokumentet e tenderimit, rekomandohet që të vendosë minimumin e kërkesës së përcaktuar me paragrafin 3 të nenit 57 të LPP-së. Kjo do të thotë se në rast se AK vendos të detyrojë depozitim e sigurisë së tenderit, **shuma e sigurimit të Tenderit të kërkohet 1% e vlerës së parashikuar të kontratës publike (kontrata me vlera të mesme ose të mëdha).**
- II. Për të gjitha aktivitetet e prokurimit që janë në procedurë të tenderimit apo të inicimit për dhënien e kontratave publike për furnizim, shërbime, punë që nuk janë emergjente si shkas i COVID-19, apo që nuk ndërlidhen me funksionimin e Administratës shtetërore, të shtyhen afatet e tenderimit/inicimit me theks të veçantë **INVESTIMET KAPITALE** në përputhje me vendimet e Ministrisë së



D.V.

Shëndetësisë të dt. 14.04.2020 për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes COVID-19 , pra në pamundësi të lëvizjes sipas vendimeve të MSH dhe sipas urdhërësës nga Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS), për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike gjatë emergjencës së shëndetit publik, dorëzimi i tenderëve duhet të shtyhet pas datës 05.05.2020

- III. Autoritetet kontraktuese (AK) nuk do t'i penalizojnë operatorët ekonomik dhe/ose të ndërmarrin masa tjera të përgjegjësisë kontraktuale në lidhje me Operatorët Ekonomik për vonesa në kryerjen e kontratave publike, nëse kontraktuesit vërtetojnë se ato vonesa janë për shkak të COVID -19.
- IV. Të gjitha kontratat në ekzekutim (të pa përfunduara) që nuk janë rezultat i procedurave emergjente/emergjenca ekstreme, apo nuk ndërlidhen me funksionimin e Administratës Shtetërore me theks të veçantë Projektet Kapitale, të zgjatet periudha e ekzekutimit të kontratës për të paktën edhe 2 muaj (afati kohor i përcaktuar në kontratën bazë) me kusht që të mos ndryshojë çmimi fillestar i kontratës bazë.

Osman VISHAJ

Kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

